

# Komunikojmë

Buletin tremujor mbi projektet për sistemin e drejtësisë në Shqipëri

KORRIK – SHTATOR 2014

NUMRI 15

## NË KËTË NUMËR:

VEPRIMTARITË NË KORRIK – SHTATOR 2014

Fillon EURALIUS IV	1
Praktikë profesionale për studentët e FDUT-së	1
Projekti “Për një drejtësi pa vonesa” në zbatim në dy gjykata shqiptare	2
Trajnim mbi regjistrimin dixhital audio për inspektorët e gjyqësorit	2
Seminar mbi inspektimin e etikës në gjyqësor	2
Vizitë studimore në Strasburg	2
E Drejta Administrative Evropiane dhe Evropa Juglindore	2
Vademekum për avokatët shqiptarë	3
Aktivitetet me Njësitë e Përbashkëta Hetimore	3
Përpjekje anti-korrupsion	3
Mbështetje për përmirësimin e kushteve të paraburgimit në komisariatet e policisë	3
Sistem vlerësimi i rrezikshmërisë penale tek autorët e mitur dhe të rinj	3
Hapësirë moderne për shërbimin e publikut në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin	4
VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË TETOR – DHJETOR 2014	

## NUMRAT E MËPARSHËM

Për t'i lexuar, klikoni ikonat e mëposhtme.



## Të nderuar lexues,

Avokatura e Shtetit, e ngritur me ligj të posaçëm që prej 15 vitesh tashmë, është institucioni i ngarkuar ekskluzivisht me dhënien e ndihmës juridike për institucionet shtetërore dhe entet publike, si shërbim këshillimor dhe përfaqësim ligjor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në fushën e të drejtave të njeriut, Avokatura e Shtetit ka një rol aktiv në propozimin e zgjidhjeve për problematikat e konsideruara shkelje nga vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kryesisht duke asistuar Ministrinë e Drejtësisë, por edhe institucione të tjera, si një urë lidhëse mes Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe qeverisë shqiptare, me qëllim final respektimin e këtyre të drejtave në Republikën e Shqipërisë.

Në mbrojtjen e çështjeve, Avokatura e Shtetit ka si qëllim kryesor uljen e numrit të gjykimeve, duke forcuar rolin këshillimor ndaj institucioneve publike. Një prezencë më e madhe e Avokaturës së Shtetit në procedurat paraprake dhe një këshillim më i mirë ligjor i institucioneve krijojnë më shumë qartësi për të drejtat dhe detyrimet, si dhe më pak konflikte. Gjithashtu, prioritetet mbeten organizimi i procedurave të konkursit të pranimit dhe hartimi i kodit të etikës dhe i sistemit të vlerësimit të avokatëve të shtetit, me qëllim ngritjen e sistemit të karrierës mbi baza objektive dhe në përfundim, rritjen e kapaciteteve të institucionit.

Avokatura e Shtetit synon të japë kontributin e saj dhe në edukimin e brezave të rinj të avokatëve, të aftë të shërbejnë me efikasitet në një fushë specifike siç është mbrojtja e interesave pasurore të shtetit. Për këtë qëllim, Avokatura organizoi këtë vit, për të parën herë, programin e Praktikës Profesionale të Studentëve të Drejtësisë me pjesëmarrjen e studentëve nga Universiteti i Tiranës. Shpresojmë që sukcesi i këtij programi të frymëzojë dhe institucionet e tjera, duke e kthyer në traditë bashkëpunimin midis arsimit të lartë dhe administratës publike.

## Sinqerisht,

Alma Hicka

Avokate e Përgjithshme e Shtetit

## VEPRIMTARITË NË KORRIK – SHTATOR 2014

### Fillon EURALIUS IV

Në vazhden e tri projekteve pararendëse, në 1 shtator 2014 filloi punën projekti EURALIUS IV, i cili do të ketë një kohëzgjatje prej 40 muajsh. Objektivi i përgjithshëm i projektit është rritja e pavarësisë, transparencës, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë në sistemin shqiptar të drejtësisë si dhe besimit të publikut në të, në pajtim me *acquis communautaire* dhe praktikatat më të mira të BE-së. Ai do të përqendrohet në pesë fusha veprimtarish: 1) Reforma në sistemin gjyqësor dhe Ministrinë e Drejtësisë; 2) Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Gjykata e Lartë; 3) Drejtësia penale dhe Prokuroria; 4) Administrata gjyqësore dhe 5) Profesionistët e ligjit. EURALIUS IV zbatohet nga një konsorcium

i përbërë nga IRZ (Deutsche Stiftung für internationalen rechtliche Zusammenarbeit e.V.) - agjenci e mandatuar nga Ministria gjermane e Drejtësisë (në rol drejtues), Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (CILC, partnere), nga Holanda dhe Agjencia për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (AED, partnere), nga Austria. Drejtues i projektit është Dr. Rainer Deville.

### Praktikë profesionale për studentët e FDUT-së

Në muajin shtator u mbyll me sukses Programi i parë i Praktikës Profesionale pranë Avokaturës së Shtetit për studentët të vitit të fundit në Programet Master Profesional dhe Shkencor në Fakultetin e

Drejtësisë të Universitetit të Tiranës (FDUT). Grupi i parë përbëhej nga 18 studentë, të cilët patën mundësi të rrisin aftësitë e tyre praktike, të zhvillohen nga pikëpamja profesionale dhe të orientohen në tregun e punës ku ata përgatiten të hyjnë si profesionistë të rinj të ligjit. Programi gjashtëmujor i praktikës profesionale u organizua falë mbështetjes së Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe USAID-it. Përmes projektit JuST, USAID-i po mbështet FDUT-në për rritjen e mundësive për praktikë profesionale për studentët e tij. Projekti ka ndihmuar në krijimin e një programi të edukimit klinik ligjor dhe ngritjen e ambienteve të Klinikës së Ligjit në këtë fakultet, si dhe po ofron trajnime mbi etikën dhe aftësitë e prezantimit të çështjes në gjyq, në të cilat përfshihen dhe gjyqë imituese.

## Projekti “Për një drejtësi pa vonesa” në zbatim në dy gjykata shqiptare

Ceremonia për prezantimin e projektit “Për një drejtësi pa vonesa” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, i cili synon të mbështesë gjyqtarët për një menaxhim aktiv të proceseve gjyqësore me qëllim shmangien e vonesave të panevojshme, u zhvillua më 10 shtator 2014. Presidenti i Republikës, Z. Bujar Nishani,

Ministri i Drejtësisë, Z. Nasip Naço, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Z. Xhezair Zaganjori, Ambasadori i SHBA-së në Tiranë, Z. Alexander Arvizu dhe Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Z. Florian Raunig, iu drejtuan një audience të gjerë gjyqtarësh, prokurorësh, avokatësh dhe përfaqësuesish të institucioneve shtetërore, të cilët janë partnerë kyç të projektit. Gjatë aktivitetit pati edhe një demonstrim përmes seancave imituese në sallë gjyqi, i cili vuri në dukje përparësitë që kanë teknikat e menaxhimit aktiv të çështjeve gjyqësore. Gjykatat e rretheve

gjyqësore Krujë dhe Korçë e kanë përfunduar plotësisht projektin “Për një drejtësi pa vonesa” dhe po arrijnë rezultate të rëndësishme në rritjen e efikasitetit të proceseve gjyqësore. Ky projekt, i hartuar nga Prezenca në bashkëpunim me USAID JuST dhe që ka mbështetur e KLD-së dhe Ministrisë së Drejtësisë, vijon zbatimin e rekomandimeve praktike të Prezencës në raportin e monitorimit të proceseve gjyqësore “Drejt Drejtësisë” të vitit 2012, sipas të cilit 47.7% e të gjitha seancave civile të monitoruara ishin tërësisht joproduktive.

## Trajnim mbi regjistrimin dixhital audio për inspektorët e gjyqësorit

Në datat 7, 8, 10 dhe 16 korrik, projekti JuST i USAID-it organizoi seanca trajnime mbi sistemin e regjistrimit dixhital audio në gjykata (RDA) dhe monitorimin e shkallës së përdorimit të tij për 20 inspektorë gjyqësorë të inspektorateve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë. Trajnimi shërbeu për t’u dhënë inspektorëve njohuri të zgjeruara mbi funksionimin e sistemit, si dhe shfrytëzimin e programit kompjuterik PAKS+, i cili bën të mundur gjenerimin automatik të raporteve mbi përdorimin e RDA-së në bazë të numrit të çështjes gjyqësore, gjyqtarit, apo datës.

## Seminar mbi inspektimin e etikës në gjyqësor

Më 9 - 11 korrik 2014, OPDAT-Shqipëri, në bashkëpunim me Ambasadën franceze, organizoi një Seminar mbi Inspektimin e Etikës në Gjyqësor për inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë. Seminari ishte pjesë e një serie aktivitetesh mbi etikën gjyqësore, ku janë përfshirë një simpozium, një seminar mbi hartimin e opinionëve gjyqësore dhe tri aktivitete të veçanta trajnime për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të gjykatave të apelit dhe shkallës së parë. Instruktorët kryesorë në seminarin e mbajtur në korrik ishin Znj. Eugene Siler, gjyqtare e apelit nga Shtetet e Bashkuara, Znj. Cynthia Eldridge, Këshilltare Ligjore Rezidente e OPDAT-Algeri

dhe Znj. Sylvie Guebel, gjyqtare karriere në pension dhe inspektore, nga Franca. Çështjet e trajtuara gjatë seminarit përfshinin, ndër të tjera, standardet e sjelljes në gjyqësor në SHBA, Francë dhe Shqipëri; mekanizmat disiplinore ndaj shkeljeve në gjyqësor; marrjen dhe hetimin e ankesave; bashkëpunimin me institucionet e tjera dhe ato të zbatimit të ligjit; si dhe përpilimin e mirë të raporteve.



*Nga Seminari mbi Inspektimin e Etikës në Gjyqësor, Tiranë, 9 korrik 2014.*



Më 25 korrik 2014, në Gjirokastrë, u zhvillua Konferenca Rajonale e Liderimit në Gjyqësor mbi përdorimin e sistemit të regjistrimit dixhital audio, ku morën pjesë të gjithë gjyqtarët, kancelarët, sekretarët gjyqësorë dhe specialistët IT të gjykatave të rretheve gjyqësore Gjirokastrë, Sarandë dhe Përmet, si dhe të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Këto gjykata përbëjnë rajonin e pestë të apelit ku sistemi RDA, i instaluar me mbështetjen e USAID JuST, po funksionon në çdo sallë gjyqi.

## Vizitë studimore në Strasburg

Vizita studimore në Strasburg për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, e organizuar nga projekti i BE / KiE-së Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë (SEJ), u zhvillua në datat 7 - 9 korrik.

Synimi i vizitës ishte që pjesëmarrësit të kuptonin më mirë mënyrën se si funksionon Këshilli i Evropës, punën e CEPEJ-it, si dhe metodologjinë dhe instrumentet e SATURN-it. Ajo kishte si qëllim edhe thellimin e mëtejshëm të njohurive mbi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet që rrjedhin prej saj.

## E Drejta Administrative Evropiane dhe Evropa Juglindore

E Drejta Administrative Evropiane nuk është e eksploruar aq sa fushat e tjera ligjore, sidomos në vendet e Evropës Juglindore (EJL). Për këtë arsye, anëtarët e Rrjetit SEELS (Shkollat Juridike të Evropës Juglindore) të

mbështetur nga GIZ ORF - LR, përgatitën dhe janë në zbatim të një projekti rajonal akademik të titulluar “E Drejta Administrative e BE-së dhe ndikimi i saj në procesin e reformimit të administratës publike dhe integritet të vendeve të EJL-së në hapësirën administrative evropiane”. Qëllimi kryesor i projektit është të trisë kërkimin shkencor dhe ekspertizën në fushën e së drejtës administrative në vendet e EJL-së. Protagonistët e kësaj përpjekjeje eksploruese janë vetë anëtarët e SEELS-it, përmes angazhimit të stafit të tyre akademik, studiuesve të shquar dhe praktikuesve të tjerë të së drejtës. Këta aktorë luajtën një rol të rëndësishëm në analizimin dhe hartimin e një studimi ndërdisiplinor mbi teorinë dhe praktikën e së drejtës administrative të BE-së, zbatimin e saj në nivel kombëtar, si edhe lehtësimin e bashkëpunimit dhe kontakteve ndërkombëtare të SEELS-it me institucionet

dhe rrjetet evropiane të linjës, të cilët operojnë në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, trajnimit dhe publikimit në këtë fushë të së drejtës. Gjetjet nga kërkimet shkencore rajonale, së bashku me rekomandime në një paraqitje krahasimore, u prezantuan në konferencën rajonale të projektit, të organizuar nga SEELS-i në mjediset e Fakultetit të Drejtësisë në Zagreb, në datat 4 dhe 5 shtator 2014. Konferenca mbledhi tridhjetepesë pjesëmarrës nga fakultetet publike të drejtësisë - anëtarë të SEELS-it (profesorë dhe asistentprofesorë), gjykatat administrative, si dhe ministritë dhe institucionet e administratës publike nga vendet e EJL-së. Konferenca i dha mundësinë edhe pjesëmarrësve nga rajoni i Kaukazit Jugor për të ndarë përvojat dhe për të përfituar nga praktikatat më të mira të EJL-së. Pas këtij aktiviteti, gjetjet e prezantuara do të mblidhen në një publikim në gjuhën angleze.

## Vademekum për avokatët shqiptarë

Në 1 korrik, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, prezantoi manualin ligjor “Vademekum për Avokatët”, i cili do t’u vijë në ndihmë avokatëve për të përmirësuar performancën e tyre në proceset gjyqësore civile. Në ceremoni

ishin të pranishëm avokatë, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe partnerë ndërkombëtarë. Manuali u hartua në kuadër të projektit “Përmirësimi i aftësive profesionale të avokatëve të rinj shqiptarë”, i zbatuar nga Prezenca dhe i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë. I përgatitur nga ekspertë të proceseve civile, Vademekumi do të shërbejë si instrument referimi në punën e përditshme të avokatëve,

veçanërisht të të rinjve në këtë profesion. Një aktivitet i dytë promovues për Vademekumin u organizua më datë 7 korrik në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, me pjesëmarrjen e studentëve të Shkollës Kombëtare të Avokatisë. Ky botim iu prezantua edhe dhomave vendore të avokatisë në Vlorë, Korçë dhe Shkodër, ndërkohë që janë planifikuar një seri aktivitetesh të tjera promovuese.

## Aktivite me Njësitë e Përbashkëta Hetimore

Më 14 korrik 2014, OPDAT-Shqipëri organizoi tryezën e rrumbullakët tremujore për drejtuesit e tetë Njësitë të Përbashkëta Hetimore (NJPH), prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme dhe ndërlidhësit e posaçëm nga tetë agjencitë e zbatimit të ligjit. Gjatë kësaj mbledhjeje u diskutua rreth rasteve të suksesshme të NJPH-ve dhe problematikën ligjore e institucionale që ato hasin. OPDAT-i

informoi rreth fushatës së ndërgjegjësimit anti-korrupsion dhe aktiviteteve trajnuese të planifikuara për NJPH-të në të ardhmen. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe Z. Eugen Beci, Drejtues i Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe Z. Francesco Ciardi, Ekspert për hetimin e krimit të organizuar nga Projekti PAMECA IV i BE-së. Përfaqësuesit nga PAMECA IV diskutuan mbi përpjekjet që shërbejnë për përmirësimin e procesit të marrjes së informacionit nga kompanitë telefonike dhe dhanë rekomandime lidhur me hetimin pasuror.

## Përpjekje anti-korrupsion

Në vizitat e zhvilluara gjatë muajit korrik 2014 në Durrës, Fier dhe Shkodër, Këshilltari Ligjor Rezident i OPDAT-it për Çështjet Anti-Korrupsion u takua me të gjithë personelin e NJPH-ve për t’i asistuar ata në punën e tyre. Ai u takua edhe me kryetarët e gjykatave të rretheve gjyqësore Durrës, Fier dhe Shkodër për të diskutuar rreth profesionalizmit të NJPH-ve dhe legjislacionit të propozuar për vlerësimin e gjyqtarëve dhe masat disiplinore kundër tyre. Gjithashtu, Këshilltari i OPDAT-it u takua me drejtorët e Drejtorive Rajonale të Policisë së Shtetit në këto qytete për të folur mbi vështirësitë e hasura nga NJPH-të gjatë hetimit të çështjeve. Diskutimet u përqendruan te shfrytëzimi i informatorëve dhe mënyrat për shpërblimin e bashkëpunëtorëve, por edhe te çështje të lidhura me personelin.

## Mbështetje për përmirësimin e kushteve të paraburgimit në komisaritet e policisë

Në kuadër të Komponentit 3 “Të drejtat e njeriut dhe policimi në komunitet” dhe pikërisht të veprimtarisë 3.2 “Mbështetje për përmirësimin e kushteve të paraburgimit në komisaritet e policisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së”, projekti PAMECA IV po mbështet Institutin Evropian të Tiranës (IET) - një OJF aktive në fushën e të drejtave të njeriut - për të përgatitur dhe organizuar disa trajnime për stafin përgjegjës të Policisë së Shtetit mbi të drejtat e personave të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar nga policia. Janë planifikuar të organizohen 10 seanca trajnime në 8 drejtori rajonale të policisë, nga korriku 2014 deri në janar 2015, sipas një kalendari të miratuar nga Policia e Shtetit dhe IET-ja. Trajnimi i parë

pilot u zhvillua në Qendrën e Formimit Policor në Tiranë, në datat 31 korrik - 1 gusht. Në të morën pjesë 15 oficerë nga Drejtoria e Policisë së Qarkut (DPQ) Tiranë. Trajnimi i dytë u zhvillua



*Nga Trajnimi mbi të Drejtat e Njeriut në Qendrën e Formimit Policor në Tiranë.*

në DPQ-në Durrës në datat 5 - 6 gusht 2014, me pjesëmarrjen e 19 oficerëve të policisë nga kjo drejtori. Një tjetër trajnim u zhvillua pranë DPQ-së Elbasan në muajin shtator. Në mbështetje të IET-së, PAMECA IV ka angazhuar për një periudhë afatshkurtër një eksperte vendase me

përvojë, për të zhvilluar trajnimin së bashku me dy ekspertë nga IET-ja. Edhe pse trajnimi bazohej në një manual të posaçëm të përgatitur nga IET-ja, ekspertja e PAMECA IV e zhvilloi atë nga një pikëpamje krahasimore. Standardet e legjislacionit shqiptar për mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave të arrestuar nga policia u krahasuan me *acquis communautaire* dhe praktikatat më të mira të BE-së. Ekspertja zhvilloi gjithashtu ushtrime praktike të modeluara sipas materialeve të trajnimit të Agjencisë për të Drejtat e Njeriut (FRA).

## Sistem vlerësimi i rrezikshmërisë penale tek autorët e mitur dhe të rinj

Në korrik, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri kryesoi një grup pune për ngritjen e një sistemi vlerësimi për rrezikshmërinë e paraqitur nga autorët e veprave penale në moshë të mitur dhe të rinj në moshë madhore, si dhe për hartimin e një manuali për përdoruesit e

tij. Grupi i punës përbëhej nga dy ekspertë ndërkombëtarë dhe katër vendas. Sistemi i vlerësimit paraqet një qasje të strukturuar për të gjithë autorët e veprave penale të rinj në moshë, duke u ndalur te shkelja e kryer dhe te faktorët që kanë çuar këta të rinj në përballje me sistemin e drejtësisë. Këta faktorë mund të variojnë nga probleme me edukimin, në ato të shëndetit mendor. Informacioni i mbledhur nga sistemi i vlerësimit mund të përdoret për hartimin e raporteve të gjykatave në mënyrë që

Shërbimi i Provës të mund të hartojë programe të duhura ndërhyrjeje. Ai shërben edhe për të matur ndryshimet te nevojat dhe rrezikun e recidivizmit me kalimin e kohës. Prezenca do të zhvillojë konsultime të gjera për sistemin e sapongritur të vlerësimit të rrezikshmërisë për të miturit dhe të rinjtë në moshë madhore. Në korrik, Prezenca organizoi dhe një trajnim katër ditor në Tiranë në lidhje me këtë sistem për rreth 30 punonjës të Shërbimit të Provës nga të gjitha zyrtarët vendore të tij.



## Hapësirë moderne për shërbimin e publikut në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin

Tani, qytetarët që i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin për shërbime dhe informacion gjejnë një hapësirë moderne të ngritur dhe pajisur nga projekti JuST i USAID-it. Kjo hapësirë mishëron standardet bashkëkohore përsa i përket ofrimit të shërbimeve për publikun në mënyrë të

efektshme e të përgjegjshme. Ajo bën të mundur që qytetarët të marrin nga gjykata shërbim apo informacion në mënyrë të përpiktë, transparente dhe të kënaqshme. Projekti në Gjykatën e Rrethit Kurbin është i treti i këtij lloji për modernizimin e hapësirës së informimit publik i realizuar nga USAID-i në gjykatat në Shqipëri. Në përmbyllje të punës së bërë, duke u mbështetur dhe në projektet e realizuara, projekti parashikon të asistojë Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (ZABGJ) për përgatitjen e një

manuali mbi hapësirat e shërbimit dhe informimit të publikut në gjykatat në Shqipëri.



Drejtori i USAID-it në Shqipëri, Z. Marcus Johnson, gjatë ceremonisë së përvurimit në Gjykatën e Rrethit Kurbin, Laç, 29 shtator 2014.

## VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË TETOR – DHJETOR 2014

- Vizitë Studimore Rajonale mbi Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve në Berlin, Gjermani, GIZ ORF-LR, 29 shtator - 3 tetor 2014
- Mision vlerësimi i një eksperti ndërkombëtar për çështjet që lidhen me efikasitetin dhe cilësinë e vlerësimit të gjyqtarëve në Shqipëri, Projekti SEJ i BE / KiE-së, 1 - 3 tetor 2014
- Trajnim njëditor për monitorues në gjykatat administrative, si pjesë e një projekti të financuar nga qeveria gjermane, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 6 tetor 2014
- Takim i Komitetit Koordinues Kombëtar për zhvillimin e sondazheve mbi nivelin e kënaqësisë së publikut në gjykata, Tiranë, Projekti SEJ i BE / KiE-së, 13 tetor 2014
- Trajnim mbi teknikat e survejimit për forcat speciale të policisë së shtetit, PAMECA IV, 13 - 17 tetor 2014
- Sesion informimi me inspektoratet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë mbi menaxhimin aktiv të çështjeve gjyqësore, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe USAID JuST, 14 tetor 2014
- Tryezë e rumbullakët me avokatët mbi çështje që kanë të bëjnë me shërbimin e provës, Vlorë dhe Shkodër, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 13 tetor dhe 4 nëntor 2014
- Ndarja e certifikatave për përfundimin me sukses të Praktikës së parë Profesionale pranë Avokaturës së Shtetit për studentët e drejtësisë së Universitetit të Tiranës, me mbështetjen e USAID JuST, 17 tetor 2014
- Dy sesione njëditore trajnimi për avokatët dhe avokatët e shtetit mbi drejtësinë administrative në Shqipëri, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 27 dhe 31 tetor 2014
- Seminar mbi hetimin dhe ndjekjen penale të veprës së korrupsionit me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Policia e Shtetit, PAMECA IV, 30 tetor 2014
- Mision vlerësimi i një eksperti ndërkombëtar me qëllim rishikimin e kurrikulës së trajnimit të Shkollës së Magjistraturës, Projekti SEJ i BE / KiE-së, 30 - 31 tetor 2014
- Shpallja e fituesve të granteve në kuadrin e kërkesës për propozime për nisma antikorrupsion, USAID JuST, tetor 2014
- Dalja e numrit të 12-të të revistës juridike “Avokatia” nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, botim i iniciuar me mbështetjen e USAID JuST, tetor 2014
- Mbledhje pune për përmirësimin e mbledhjes dhe analizimit të statistikave gjyqësore, Tiranë, Projekti SEJ i BE / KiE-së, 3 - 7 nëntor 2014
- Tryezë e rumbullakët rajonale me temë “Promovimi i profesionistëve femra në fushën e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve: Eksperienca dhe praktikat më të mira”, Tiranë, GIZ ORF-LR, 14 nëntor 2014
- Trajnim trajnerësh për pedagogët e Shkollës së Magjistraturës dhe administratorët e gjykatave pilote mbi instrumentet e CEPEJ-it për cilësinë, si dhe takime për Programin e Trajnimit për Gjykatat (Court Coaching), Tiranë, Projekti SEJ i BE / KiE-së, 17 - 21 nëntor 2014
- Shtirja e teknologjisë së regjistrimit dixhital audio në gjykata të apelit Shkodër, USAID JuST, tetor - nëntor 2014
- Seancë gjyqësore imituese me Shkollën Kombëtare të Avokatisë, e koordinuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, nëntor 2014



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE

USAID JuST  
E-mail: [office@ajssp.org.al](mailto:office@ajssp.org.al)  
[www.usaid.org/albania](http://www.usaid.org/albania)



Organization for Security and  
Co-operation in Europe  
Presence in Albania

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri  
E-mail: [pm-al@osce.org](mailto:pm-al@osce.org)  
[www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)



EURALIUS IV  
E-mail: [info@euralius.eu](mailto:info@euralius.eu)  
[www.euralius.eu](http://www.euralius.eu)



OPDAT-Shqipëri  
E-mail: [GriseDP@state.gov](mailto:GriseDP@state.gov)  
[www.justice.gov/criminal/opdat](http://www.justice.gov/criminal/opdat)



**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

GIZ ORF-LR  
E-mail: [orflex-al@giz.de](mailto:orflex-al@giz.de)  
[www.giz.de](http://www.giz.de)



E-mail: [info@pameca.org.al](mailto:info@pameca.org.al)  
[www.pameca.org.al](http://www.pameca.org.al)



Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE  
CONSEIL DE L'EUROPE

BE / KiE Mbështetje për Efikasitetin në Drejtësi - SEJ  
E-mail: [Tea.Jalishvili@coe.int](mailto:Tea.Jalishvili@coe.int)  
[www.coe.al](http://www.coe.al)

## Shprehjet e falënderimit dhe mbi përgjegjësitë

17 tetor 2014. Artikujt e buletinit janë kontribute të projekteve të donatorëve që mbështesin aktivisht reformën në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Kontribuuesit mbajnë përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e artikujve të tyre, të cilat nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve apo qeverive përkatëse.